



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS¹

DRAFT LAW ON BAR EXAMINATION²

NACRT ZAKONA O PRAVOSUDNOM ISPITU³

¹ Projektligji për Provimin e Jurisprudencës, është miratuar në mbledhjen e 31-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 04/31, të datës 25.08.2021.

² Draft Law on Bar Examination, was approved on the 31th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 04/31, dated 25.08.2021.

³ Nacrt Zakona o Pravosudnom Ispitu, usvojen je na 31 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 04/31, datum 25.08.2021.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës;</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS</p> <p>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë organizimin e provimit, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për dhënien e provimit, si dhe mënyrën e verifikimit dhe vlerësimit të aftësive teorike dhe praktike të juristëve të diplomuar për ushtrimin e pavarur të profesionit.</p>	<p>The Assembly of the Republic of Kosovo;</p> <p>In accordance with Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>approves:</p> <p>LAW ON BAR EXAMINATION</p> <p>CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this law is to regulate the organization of the exam, the composition and functioning of the Commission for passing the exam, as well as the manner of verification and evaluation of the theoretical and practical skills of graduated lawyers for the independent exercise of the profession.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo;</p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>usvaja:</p> <p>ZAKON O PRAVOSUDNOM ISPITU</p> <p>POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>Svrha ovog zakona je da reguliše organizaciju ispita, sastav i funkcionisanje Komisije za polaganje ispita, kao i način provere i ocenjivanja teorijskih i praktičnih veština diplomiranih pravnika za samostalno vršenje struke.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Ligji zbatohet nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni për dhënien e provimit të Jurisprudencës si dhe kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit, siç përcaktohet me dispozitat e këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Law shall be implemented by the Ministry of Justice, the Commission for passing the bar examination, as well as the candidates who undergo the exam, as determined by the provisions of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Određbe ovog zakona sprovode se od Ministarstva pravde, Komisije za polaganje pravosudnog ispita kao i kandidata koji se podvrgnu ispitu, kao što je određeno odredbama ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Komisioni - nënkupton Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës, si organ i pavarur profesional i propozuar nga Ministri i Drejtësisë dhe i emëruar nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>1.2. Anëtari i komisionit - nënkupton personin i cili është emëruar në pajtim me dispozitat e këtij Ligji;</p> <p>1.3. Kandidati - nënkupton personin i cili i plotëson kushtet për t'iu nënshtuar provimit të jurisprudencës;</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Commission – means the Commission for passing the bar examination, as an independent professional body, proposed by the Minister of Justice and appointed by the Assembly of Kosovo.</p> <p>1.2. Commission Member – means the person who has been appointed in accordance with the provisions of this Law;</p> <p>1.3. Candidate – means the person who meets the requirements to sit the bar examination;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom zakonu imaju ovo značenje:</p> <p>1.1. Komisija - znači Komisija za polaganje pravosudnog ispita, kao nezavisno stručno telo, koje predlaže ministar pravde, a imenuje Skupština Kosova.</p> <p>1.2. Član komisije - znači lice koje je imenovano u skladu sa odredbama ovog zakona;</p> <p>1.3. Kandidat - znači osoba koja ispunjava uslove da se podvrgne pravosudnog ispita;</p>

<p>1.4. Sekretari i Komisionit – nënkupton zyrtarin i cili merret me punët profesionale dhe administrative për nevojat e Komisionit për organizimin e provimit, të emëruar me vendim të Ministrit të Drejtësisë.</p> <p>KAPITULLI II - ORGANIZIMI I PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT</p> <p>Neni 4 Organizimi i provimit të jurisprudencës</p> <p>1. Organizimi dhe mbajtja e provimit të jurisprudencës është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>2. Provimi i Jurisprudencës organizohet tre (3) herë brenda një (1) viti kalendarik.</p> <p>3. Provimi i jurisprudencës mbahet nga Komisioni.</p>	<p>1.4. Commission Secretary – means the officer who deals with professional and administrative works for the needs of the Commission for organizing the examination, appointed by the decision of the Minister of Justice.</p> <p>CHAPTER II - ORGANIZATION OF BAR EXAMINATION AND COMPOSITION OF THE COMMISSION</p> <p>Article 4 Organization of Bar Examination</p> <p>1. The organization and sitting of bar examination is a competence of the Ministry of Justice.</p> <p>2. The bar examination is organized three (3) times within one (1) calendar year.</p> <p>3. The bar examination is held by the Commission.</p>	<p>1.4 Sekretar Komisije - podrazumeva službenog lica koje se bavi stručnim i administrativnim poslovima za potrebe Komisije za organizaciju ispita, koji je imenovan odlukom ministra pravde.</p> <p>POGLAVLJE II - ORGANIZACIJA PRAVOSUDNOG ISPITA I SASTAV KOMISIJE</p> <p>Član 4 Organizacija pravosudnog ispita</p> <p>1. Organizacija i održavanje pravosudnog ispita nadležnost je Ministarstva pravde.</p> <p>2. Pravosudni ispit se organizuje tri (3) puta u toku jedne (1) kalendarske godine.</p> <p>3. Pravosudni ispit se održava od Komisije.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 5 Komisioni për dhënien e provimit të Jurisprudencës</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Commission for Passing the Bar Examination</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Komisija za polaganje pravosudnog ispita</p>
<p>1. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë duke përfshirë kryetarin e Komisionit dhe anëtarët e Komisionit. Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendësit e tyre të cilët veprojnë në mungesë të tyre. Anëtarët e Komisionit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore.</p> <p>2. Kryetarin, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre i propozon Ministri i Drejtësisë dhe i emëron Kuvendi i Kosovës, me mandat tri (3) vjet, pa mundësi riemërimi.</p> <p>3. Komisioni përbëhet nga radhët e juristëve të diplomuar të cilët duhet ta kenë të dhënë provimin e jurisprudencës, si dhe të kenë së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale.</p> <p>4. Kryetarit, anëtarëve përkatësisht zëvendësve anëtarëve të Komisionit, u takon kompensim për punën e kryer në Komision. Shumën e kompensimit e cakton Ministri me vendim e që nuk mund të jetë përtej kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>1. The Commission shall consist of five (5) members including the president of the Commission and members of the Commission. The president and members have their deputies who act in their absence. The members of the commission shall reflect the multi-ethnic nature and the principles of gender equality.</p> <p>2. The president, members of the commission and their deputies shall be proposed by the Minister of Justice and appointed by the Assembly of Kosovo with a mandate of three (3) years, without the possibility of reappointment.</p> <p>3. The Commission shall consist of graduated lawyers who have passed the bar examination and have at least eight (8) years of professional work experience.</p> <p>4. The president, the members, and the deputy members of the Commission respectively, shall be compensated for the work performed in the Commission. The amount of compensation shall be determined by a decision of the Minister, which cannot go beyond the limits specified in the relevant legislation in force.</p>	<p>1. Komisija se sastoji od pet (5) članova, uključujući predsednika Komisije i članova Komisije. Predsednik i članovi imaju svoje zamenike koji deluju u njihovom odsustvu. Članovi komisije odražavaju multietničku prirodu i principe rodne ravnopravnosti.</p> <p>2. Članove komisije i njihove zamenike predlaže ministar pravde, a imenuje Skupština Kosova sa mandatom od tri (3) godine i bez mogućnošću ponovnog imenovanja.</p> <p>3. Komisiju čine diplomirani pravnici koji treba da imaju položen pravosudni ispit, kao i da imaju najmanje osam (8) godina profesionalnog radnog iskustva.</p> <p>4. Predsednik, članovi, odnosno zamenici članova Komisije, imaju pravo na naknadu za obavljene rad u Komisiji. Visinu naknade određuje ministar odlukom, a naknada ne može biti veća od ograničenja utvrđenih relevantnim zakonodavstvom na snazi.</p>

<p>5. Mbështetja administrative dhe teknike për Komisionin ofrohet nga Sekretari i Komisionit për provim të jurisprudencës, të cilit i takon kompensimi për punë jashtë orari, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>6. Për qëllime të këtij neni përvojë pune profesionale nënkupton përvojën si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor universitar i fushës së drejtësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Shpenzimet</p> <p>1. Kandidati i bartë shpenzimet e dhënies së provimit të jurisprudencës. Lartësinë e të cilave e cakton me vendim Ministri i Drejtësisë.</p> <p>2. Kandidatët në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale të cilët janë shfrytëzues të ndihmës sociale dhe invalidët e luftës me mbi 50 % të shkallës së invaliditetit të cilët dëshmojnë me dokumente zyrtare, për hyrjen në provim do të lirohen nga pagesa me vendim të Ministrit.</p>	<p>5. Administrative and technical support for the Commission shall be provided by the Secretary of the Commission for bar examination, who is entitled to compensation for overtime work, in accordance with the relevant legislation in force.</p> <p>6. For the purposes of this Article, professional work experience means experience as a judge, prosecutor, lawyer, university professor in the field of law.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Expenditures</p> <p>1. The candidate shall bear the costs of the bar examination, the amount of which shall be determined by a decision of the Minister of Justice.</p> <p>2. Candidates of poor economic and social status who are beneficiaries of social assistance, and war invalids with over 50% of the degree of disability, evidenced with official documents, will be exempted from payment for entering the exam by a decision of the Minister.</p>	<p>5. Administrativnu i tehničku podršku Komisiji pruža sekretar Komisije za pravosudni ispit, koji ima pravo na plaćanje prekovremenog rada, u skladu sa važećim zakonodovastvom.</p> <p>6. Za potrebe ovog članka, radno iskustvo znači iskustvo kao sudija, tužioca, advokata, univerzitetski profesor iz oblasti prava.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Troškovi</p> <p>1. Kandidat snosi troškove polaganja pravosudnog ispita. Njegova visina se određuje odlukom ministra pravde.</p> <p>2. Kandidati u teškoj ekonomskom i socijalnom stanju koji su korisnici socijalne pomoći i ratni invalidi sa preko 50% stepena invaliditeta koji to dokažu službenim dokumentima, za polaganje ispita biće oslobođeni od plaćanja odlukom ministra.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 7 Shmangia nga konflikti i interesit</p> <p>Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, anëtarët e komisionit obligohen ta njoftojnë me shkrim Sekretarin e Komisionit para mbajtjes së provimit në rast se ekziston konflikt i interesit, apo situata që e vënë në dyshim objektivitetin në vendim marrje.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Avoidance of conflict of interest</p> <p>In order to avoid conflict of interest, based on the Law on Prevention of Conflict of Interest in the Exercise of Public Function, before holding the examination, members of the Commission are obligated to notify in writing the Commission Secretary, in case of conflict of interest or situations that call into question their objectivity in decision-making.</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Izbjegavanje sukoba interesa</p> <p>U cilju izbegavanja sukoba interesa, na osnovu Zakonu o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije, članovi komisije dužni su da pre ispita pismeno obavestavaju o tome Sekretar Komisije u slučaju da postoji sukob interesa, ili situacije koje dovode u pitanje objektivnost u odlučivanju.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI III - KUSHTET PËR PARAQITJEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III - REQUIREMENTS ON APPLYING FOR THE BAR EXAMINATION</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE III - USLOVI ZA POLAGANJE PRAVOSUDNOG ISPITA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Kushtet për paraqitjen e provimit</p> <p>1. Kandidati i cili i nënshtrohet provimit duhet t'i plotësojë këto kushte:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. të ketë përfunduar Fakultetin Juridik;</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Requirements on Applying for the Bar Examination</p> <p>1. A candidate who enters the examination must meet the following requirements:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. have completed Law Faculty;</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Uslovi za polaganje ispita</p> <p>1. Kandidat koji se podvrgne ispitu mora ispunjavati ove uslove:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. da bude državljanin Republike Kosova;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. da je diplomiran na Pravnom fakultetu;</p>

<p>1.3 të ketë punuar apo kryer praktikë një (1) vjeçare në gjykata, prokurori të shtetit, në zyrë të avokatisë;</p> <p>1.4 të ketë punuar dy (2) vite punë profesionale në zyre noteriale, zyre përmbartimore, institucione publike, ndërmarrje, agjenci shtetërore, shoqëri tregtare, përvojë profesionale në organizata joqeveritare të fushës së drejtësisë apo në administratën e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, ose jashtë vendit.</p> <p>2. Vërtetimet për praktikën e kryer dhe përvojën sipas nënparagrafit 1.3 dhe 1.4 të jenë të lëshuara nga institucionet përkatëse, llogaritet pas përfundimit të nivelit themelor të studimeve.</p> <p>3. Kandidati i cili ka kryer Fakultetin Juridik në ndonjë universitet jashtë Kosovës, duhet të ketë nostrifikuar diplomën e Fakultetit Juridik, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.</p> <p>4. Përjashtimisht paragrafit 1.1 të këtij neni, kandidati nga shteti i huaj i cili ka të kryer Fakultetin Juridik në ndonjë institucion të arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Kosovës, mund t'i nënshtrohen provimit të</p>	<p>1.3. have worked or held internship for one (1) year in courts, state prosecution offices, law offices;</p> <p>1.4. have two (2) years of professional work experience in notary offices, enforcement agent offices, public institutions, enterprises, state agencies, business organizations, professional experience in non-governmental organizations in the field of justice, or administration of international institutions in Kosovo or abroad.</p> <p>2. Certificates on the completion of internship and experience under sub-paragraphs 1.3 and 1.4 are calculated after the completion of the basic studies, which must be issued by the respective institutions</p> <p>3. A candidate who has completed Faculty of Law in any university abroad should nostrify the diploma of Faculty of Law at the Ministry of Education, Science and Technology.</p> <p>4. Notwithstanding paragraph 1.1 of this Article, a candidate from a foreign country who has completed the Faculty of Law in a higher education institution accredited in the Republic of Kosovo, may sit the bar</p>	<p>1.3 da je radio ili završio praksu, jednu (1) godinu u sudovima, državnim tužilaštvima, advokatskoj kancelariji;</p> <p>1.4 da je radio dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u javnim institucijama, preduzećima, državnim agencijama, kompanijama, profesionalno iskustvo u nevladinim organizacijama u oblasti pravosuđa, ili u administraciji međunarodnih institucija na Kosovu ili u inostranstvu.</p> <p>2. Potvrde o završetku prakse i iskustvo prema podstavima 1.3 i 1.4, izdate od strane relevantnih institucija, i to se računaju nakon završetka osnovnog nivoa studija.</p> <p>3. Kandidat koji je završio Pravni fakultet na univerzitetu van Kosova, mora da ima nostrificiranu diplomu Pravnog fakulteta u Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije.</p> <p>4. Izuzev stava 1.1 ovog člana, kandidat iz strane države koji je završio Pravni fakultet u visokoškolskoj ustanovi akreditovanoj u Republici Kosovo, može položiti pravosudni ispit samo uz dozvolu boravka u Republici Kosovo.</p>
--	---	---

<p>jurisprudencës vetëm me leje qëndrimin në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Lëndët e provimit të jurisprudencës</p> <p>1. Provimi i jurisprudencës përbëhet nga lëndë si në vijim:</p> <p>1.1 E drejta penale (materiale dhe procedurale);</p> <p>1.2 E drejta civile (materiale dhe procedurale);</p> <p>1.3 E drejta kushtetuese dhe bazat e sistemit gjyqësor;</p> <p>1.4 E drejta tregtare, e drejta e punës dhe e drejta administrative;</p> <p>1.5 E drejta ndërkombëtare (private dhe publike) dhe e Drejta e Bashkimit Evropian.</p>	<p>examination only with a residence permit in the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Bar Examination Subjects</p> <p>1. The bar examination consists of the following subjects:</p> <p>1.1. Criminal Law (substantive and procedural);</p> <p>1.2. Civil Law (substantive and procedural);</p> <p>1.3. Constitutional Law and foundations of judicial system;</p> <p>1.4. Commercial Law, Labor Law and Administrative Law;</p> <p>1.5. International Law (private and public) and European Union Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Predmeti pravosudnog ispita</p> <p>1. Pravosudni ispit sastoji se od sledećih predmeta:</p> <p>1.1 Krivično pravo (materijalno i proceduralno);</p> <p>1.2 Građansko pravo (materijalno i proceduralno);</p> <p>1.3 Ustavno pravo i temelji pravosudnog sistema;</p> <p>1.4 Privredno pravo, radno pravo i upravno pravo;</p> <p>1.5 Međunarodno pravo (privatno i javno pravo) i pravo Evropske unije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Vlerësimi i njohurive për dispozitat ligjore</p> <p>Komisioni vlerëson njohuritë për dispozitat ligjore dhe praktikën gjyqësore, njohuritë për institucionet juridike, shkathtësitë e të</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Knowledge Assessment on Legal Provisions</p> <p>The Commission assesses knowledge of legal provisions and case law, knowledge of legal</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Procenjivanje znanja o zakonskim odredbama</p> <p>Komisija procenjuje znanje o zakonskim odredbama i sudskoj praksi, znanje o pravnim institucijama, veštine argumentacije</p>

<p>argumentuarit dhe të shkrimit juridik dhe të gjykuarit sipas ligjit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Programi për provimin e jurisprudencës</p> <p>Ministri i Drejtësisë me akt nënligjor përcakton Plan Programin për provimin e jurisprudencës i cili përmban lëndët, burimet juridike dhe literaturën për çdo lëndë siç parashihet me dispozitat e këtij ligji.</p>	<p>institutions, argumentative skills, and legal writing and reasoning according to law.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Bar Examination Program</p> <p>The Minister of Justice, with a sub-legal act shall determine, the Program Plan for the bar examination, which contains the subjects, legal resources and literature for each subject as provided by the provisions of this Law.</p>	<p>i pravnog pisanja i suđenja u skladu sa zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Program za pravosudni ispit</p> <p>Ministar pravde podzakonskim aktom utvrđuje Programski plan za pravosudni ispit koji sadrži predmete, pravna resursa i literaturu za svaki predmet kako je predviđeno odredbama ovog zakona</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI IV - PROCEDURA E PROVIMIT JURISPRUDENCES</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Kërkesa për provim</p> <p>1. Kërkesa për provim paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë.</p> <p>2. Kandidati kërkesës për provim ia bashkangjet dëshminë mbi plotësimin e kushteve sipas dispozitave të këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER IV - BAR EXAMINATION PROCEDURE</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Exam Application</p> <p>1. Exam application is submitted at the Ministry of Justice.</p> <p>2. The candidate attaches to the exam application the evidence of fulfilling the requirements according to the provisions of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE IV - POSTUPAK PRAVOSUDNOG ISPITA</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Zahtev za ispit</p> <p>1. Zahtev za ispit podnosi se Ministarstvu pravde.</p> <p>2. Kandidat uz zahtev za ispitivanje prilaže dokaze o ispunjavanju uslova u skladu sa odredbama ovog zakona.</p>

<p>3. Kandidati në kërkesë deklaroi se në cilën gjuhë zyrtare dëshiron t'i nënshtrohet provimit apo përdorim zyrtar.</p> <p>4. Komisioni i emëruar nga Ministri i Drejtësisë, me vendim përcaktoi se kandidati i plotëson ose nuk i plotëson kushtet që t'i nënshtrohet provimit.</p> <p>5. Kundër vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, kandidati mund të paraqes ankesë në afat brenda tetë (8) ditëve. Ankesa i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë, i cili vendos brenda afatit prej pesë (5) ditëve. Ndaj vendimit të Ministrisë pala e pa kënaqur mund të fillojë konfliktin administrativ sipas ligjit në fuqi.</p> <p>6. Komisioni nga paragrafi 4 i këtij neni emëtohet me vendim nga Ministri i Drejtësisë, përbëhet nga kryesuesi dhe dy anëtarë të cilët janë zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Afatet e organizimit të provimit të jurisprudencës</p> <p>Ministria e Drejtësisë cakton afatet e provimit të Jurisprudencës.</p>	<p>3. Candidate in the application shall declare the official language in which he/she wishes to sit the exam or official use.</p> <p>4. The Commission appointed by the Minister of Justice determines by decision if the candidate meets or does not meet the requirements to sit the bar examination.</p> <p>5. Against the decision under paragraph 4 of this Article, the candidate may file an appeal within eight (8) days. The appeal is submitted to the Minister of Justice, who within five (5) days shall decide on the appeal. An administrative conflict may be initiated against the decision of the Minister according to the legislation in force.</p> <p>6. The Commission under paragraph 4 of this Article is appointed by a decision of the Minister of Justice, it consists of the president and two members who are officers at the Ministry of Justice.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Bar Examination Dates</p> <p>The Ministry of Justice sets the dates for the bar examination.</p>	<p>3. Kandidat u zahtev izjavljuje na kojem službenom jeziku želi da se podvrgne ispitu ili službenu upotrebu.</p> <p>4. Komisija, koja je imenovana od strane ministra pravde, odlukom utvrđuje da li kandidat ispunjava ili ne ispunjava uslove da se podvrgne ispitu.</p> <p>5. Protiv odluke iz stava 4. ovog člana kandidat može podneti žalbu u roku od osam (8) dana. Žalba se podnosi Ministar pravde koji odlučuje u roku od pet (5) dana. Protiv odluke Ministar pravde dozvoljeno je pokretanje upravnog spora prema važećem zakonu.</p> <p>6. Komisija iz stava 4 ovog člana imenuje se odlukom ministra pravde, koja se sastoji od predsednika i dva člana koji su službenici Ministarstva pravde.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Rokovi za organizovanje pravosudnog ispita</p> <p>Ministarstvo pravde postavlja rokove za polaganje pravosudnog ispita.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 14 Mënyra e mbajtjes së Provimit</p> <p>1. Provimi i jurisprudencës mbahet në dy pjesë, pjesa e provimit me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë.</p> <p>2. Kandidati i cili nuk e kalon pjesën e provimit me shkrim nuk ka të drejtë të vazhdojë më tutje në pjesën e provimit me gojë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Manner of Sitting the Examination</p> <p>1. The bar examination is held in two parts, the written examination part and the oral examination part.</p> <p>2. The candidate who does not pass the written examination part is not entitled to further continue with the oral examination part.</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Način održavanja ispita</p> <p>1. Pravosudni ispit se održava u dva dela, deo pismenog ispita i deo usmenog ispita.</p> <p>2. Kandidat koji ne polaže deo pismenog ispita nema pravo da nastavi dalje u delu usmenog ispita.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Provimi me shkrim</p> <p>1. Provimi me shkrim përbëhet nga dy (2) detyra. Përmes detyrave me shkrim kandidatit i vlerësohet aftësia për përgatitjen parashtrësive, duke përfshirë por pa u kufizuar në përpilimin e: padive, përgjigje në padi, aktakuzë, vendim (aktgjykimit ose aktvendimit) apo mjetet juridike kundër vendimeve.</p> <p>2. Në provim me shkrim mund të jepet një detyrë për të gjithë kandidatët, të cilët në të njëjtën kohë i nënshtrohen pjesës së provimit me shkrim, por mund të caktohen edhe detyra të veçanta për më shumë kandidatë të një grupi. Pas çdo afati Komisioni ndryshon detyrën.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Written Examination</p> <p>1. The written examination consists of two (2) assignments. Through written assignments the candidate is assessed the ability to prepare submissions, including but not limited to drafting: lawsuits, response to lawsuits, indictment, decision (judgment or ruling) or legal remedies against decisions.</p> <p>2. In the written examination one assignment can be given for all candidates, who sit the written examination at the same time, but special assignments can also be assigned for more candidates of a group. After every term the Commission shall change the assignment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Pismeni ispit</p> <p>1. Pismeni ispit se sastoji od dva (2) zadatka. Kroz pismene zadatke kandidatu se ocenjuje sposobnost pripreme podnesaka, uključujući, ali ne ograničavajući se na sastavljanje: tužbe, odgovor na tužbe, optužnice, odluke (presude ili presude) ili pravne lekove protiv odluka.</p> <p>2. Na pismenom ispitu može se dati jedan zadatak za sve kandidate, koji se istovremeno podvrgnu pismenog dela ispita, ali mogu se dodeliti posebni zadaci za više kandidata u grupi. Nakon svakog termina Komisija će promeniti zadatak.</p>

<p>3. Në pjesën e provimit me shkrim kandidati i nënshtrohet provimit në pjesën penale dhe në pjesën civile.</p> <p>4. Në pjesën e provimit me shkrim kandidati vlerësohet me “kalon” apo “nuk kalon”.</p> <p>5. Kandidati i cili kalon pjesën e provimit me shkrim, lejohet t’i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë.</p>	<p>3. In the written part of the examination, the candidate undergoes the exam in the criminal part and in the civil part.</p> <p>4. In the written part of the examination the candidate is assessed with “passes” or “does not pass”.</p> <p>5. The candidate who passes the written part of the examination is allowed to take the oral part of the examination.</p>	<p>3. Na pismenom delu ispita kandidat se podvrgne ispitu u krivičnom delu i u građanskom delu.</p> <p>4. U delu pismenog ispita kandidat se ocenjuje sa "položio" ili "nije položio".</p> <p>5. Kandidat koji polaže pismeni deo ispita ima pravo da se podvrgne usmenog ispita.</p>
<p>Neni 16 Procedura gjatë provimit me shkrim</p>	<p>Article 16 Written Examination Procedure</p>	<p>Član 16 Procedura tokom pismenog ispita</p>
<p>1. Provimi me shkrim mbahet në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët.</p> <p>2. Në pjesën e provimit me shkrim marrin pjesë pyetësit e lëndëve përkatëse si dhe Sekretari i Komisionit.</p> <p>3. Koha për kryerjen e detyrës me shkrim është katër (4) orë nga koha kur detyra i shpërndahet të gjithë kandidatëve dhe se nga ai moment fillon llogaritja e kohës.</p> <p>4. Kandidati është i obliguar ta dorëzojë detyrën me shkrim brenda kohës së përcaktuar për kryerjen e saj.</p>	<p>1. The written examination is held at the same time for all candidates.</p> <p>2. The questioners of the respective subjects as well as the Commission Secretary participate in the written part of the examination.</p> <p>3. The time for completing the written assignment is four (4) hours from the time when the assignment is distributed to all candidates and the calculation of time starts from that moment.</p> <p>4. The candidate is obligated to submit the written assignment within the time specified for its completion.</p>	<p>1. Pismeni ispit se održava istovremeno za sve kandidate.</p> <p>2. U pismenom delu ispita učestvuju ispitivači relevantnih predmeta kao i Sekretar Komisije.</p> <p>3. Vreme za vršenje pismenog zadatka je četiri (4) sata od trenutka kada je zadatak dostavljen svim kandidatima i od tog trenutka počinje računanje vremena.</p> <p>4. Kandidat je dužan da pismeni zadatak preda u roku određenom za njegovo vršenje.</p>

